



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01 Nr.60/01-14892 /23
Kaçanik 23.06.2023

FTESË PËR MBLEDHJE

Të nderuar anëtarë të Komitetit për Komunitete, me datën 27.06.2023 (e martë), do të mbahet mbledhja e VI (gjashtë) e rregullt e Komitetit për Komunitete, për vitin 2023. Mbledhja do të mbahet në katin e dytë të objektit të komunës në sallën e Komiteteve, më fillim pune në ora 11:00.

Mbledhjen do ta kryeson dhe udhëheq, Ekrem Livoreka, Kryesues i Komitetit për Komunitete.

Në mbledhjen e VI (gjashtë) të Komitetit për Komunitete, të datës 27.06.2023, do të shqyrtohet ky:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Komunitete;
2. Gjendja e sigurisë në komunën e Kaçanikut ;
3. Të ndryshme.

Ju mirëpresim,

Me respekt!

Kryesues i Komitetit për Komunitete
Ekrem Livoreka



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr. 60/01- 12144/23
Kaçanik, 25.05.2023

PROCESVERBAL

Nga mbledhja **V (pestë)** e Rregullt e Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 25 maj 2023 (e enjte). Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës Komunale, në sallën e komiteteve të Kuvendit, me fillim pune në ora 11:00.

Pjesëmarrës të këtij takimi nga Komiteti për Komunitete ishin: Arta Avdiu-LVV, Ekrem Livoreka-AAK, Betim Shala-LDK, Arben Thaqi- OJQ. Në mbledhje mungoj, Lejla Muhaxheri-Çaka-PDK.

Nga Ekzekutivi i komunës nuk mori pjesë ndonjë zyrtar, ndërkaq e ftuar ishte Drejtoresha për kultur rini dhe sport, Hafize Sallahu.

Mbledhjen e udhëhoqi, kryesuesi i Komitetit për Komunitete, Ekrem Livoreka. Procesmbajtëse Mavije Murseli, Asistente e Kryesuesit të Kuvendit.

z.Ekrem Livoreka: Fillimisht përshëndes të pranishmit, konstatoj kuorumin dhe hapi mbledhjen e V-të (pestë) të rregullt të Komitetit për Komunitete për vitin 2023, data 25 maj, me këtë :

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Komunitete;
2. Ndarja e granteve dhe subvencioneve për OJQ; dhe
3. Të ndryshme.

Nëse ka diçka rreth rendit të punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendi i punës u shtrua në votim dhe u votua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së Komiteti për Komunitete.

APROVOJ

Rendin e punës, në përbërje prej 3 pikave

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas renditjes:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e fundit e Komitetit për Komunitete

Kryesues i Komitetit Ekrem Livoreka: A keni ndonjë vërejtje rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo atëherë, a jeni për miratimin e këtij procesverbalit ?

Procesverbali i mbledhjes së IV (katërt) të Komitetit për Komunitete i vitit 2023, u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi se Komitetit për Komunitete e,

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes së IV (katërt) të Komitetit për Komunitete të vitit 2023, të datës 27.04.2023 / Lënda : 01Nr. 60/01-9429/23.

2. Ndarja e granteve dhe subvencioneve për OJQ;

z.Arben Thaqi: Siç dihet grantet ndikojnë në zhvillimin e OJQ-ve, si dhe në cilësinë e aktiviteteve. Një ndër pyetjet të cilën e kam shtruar ka qenë lidhur me cilësinë apo masivitetin, dy elemente të cilat e determinojnë një graf. Sa i përket aspektit të cilësisë nësi komunë qendrojmë shumë keq, ndërsa tek masiviteti mund të themi se është përmisuar për shkak se është rritur numri i OJQ-ve dhe si rezultat i kësaj kemi masivitet më të madh të sportistave dhe gara sportive. Zakonisht është thirrja publike që bëhet për OJQ-të dhe ndarjeve të granteve, Shuma e përgjithshme për grantet arrin vlerën afërsisht 66.000.00 euro. Në fushën e rinisë dhe sportit 44.500.00 €, në fushën e kultures 19.500.00 €. Bazuar në këtë ndarje të mjeteve kemi këtë ndarje si: Keshilli Veprimtar Rinor Lokal 1,500.00 €, Klubi i Mundjes Kaçaniku 1,700.00 €, Shoqata e Pedagogëve Kultures Fizike dhe Sportit Shkollor 1,500.00 €, Klubi i Shahut Lepenci 1,300.00 €, Klubi i Volejbollit për femra Kaçaniku 3,400.00 €, Klubi i Volejbollit Kaçaniku Meshkujt 2,600.00 €, Klubi i Futbollit të femrave Bazeli 2015 Bicec 3,800.00 €, Klubi i Futbollit Lepenci 16,700.00 €, Klubi i Taekeondo 1,500.00 €, Klubi i Basketbollistik Kaçaniku – Meshkujt 3,700.00 €, Fondacioni Bonevet 2,000.00 €, Shoqata bjeshkatëre alpiniste “Kaçaniku 2015” 1,400.00 € dhe për Motokross Kaçaniku 1,400.00 €.

znj.Arta Avdiu: Cilat janë kriteret për ndarjen e subvencioneve, qfarë kërkesë duhet bërë, po ashtu nëse je i regjistruar si OJQ dhe nëse nuk merr pjesë në gara a takon subvencionin.

z.Arben Thaqi: Çdo OJQ, duhet me e mbyll atë program, nëse nuk e mbyll atë program dhe nëse nuk arsytohen ato mjete, me automatizem penalizohet për vitin tjetër, si shkas i gjithë kësaj nuk mundesh me përfitu grantin, sepse thjesht nuk e keni mbyllur një projekt, nëse nuk ka aktivitet nuk ka shpenzime.

Çdo parashtues i kërkesës për subvencione duhet të posedojë këto dokumente:

1. Dokumenti identifikues i Republikës së Kosovës
2. Certifikatën e regjistrimit të biznesit
3. Numri i llogarisë bankare të përfituesit
4. Vertetimi tatimor nga ATK, që përfituesi nuk ka obligime tatimore
5. Vertetim që je klub sportive dhe
6. Vertetim nga Federata e futbollit që jeni i regjistruar dhe që realizoni aktivitetet-gara brenda institucionit si dhe dhe një vertetim nga komuna për njohjen e organizatës si OJQ.

Te ndarja e granteve një prej tyre është klubi Lepenci, kam qenë pjesë e këtij klubi dhe është klubi që kemi qenë krenarë me sukseset e tyre. Në rastin e Lepencit edhe pse ndahet një shumë e madhe e mjeteve financiare, ndonjëherë ato mjete financiare nuk po dihet se për çka janë duke u shfrytëzuar, thjesht nuk po vrehen se ku po kanalizohen këto mjete tek Lepenci, ndoshta mund të themi se nuk janë mjaftueshëm sepse sportistat dhe klubet sportive kanë gjithmonë nevojë për më shumë mjete financiare mirëpo Lepenci vazhdimisht po hasë në probleme që do të thotë këtu është një pikpyetje e madhe!

Përveq historikut të klubit të Lepencit që ka qenë një historik i superliges dhe thjesht ka një organizim si publik shumë të mirë, mipro sa i përket drejtësisë unë kam qenë pjesë e

Lepencit dhe kam verjetur shum gjera që nuk lenë me deshiru, duke filluar nga problematika e përcaktimit dhe anagazhimit të detyrave të punës nga personat të cilët janë të anagzhuar në këtë klub. Aty është një person që punon dhe ai është kryesori që i kryen të gjitha punët mirpo jan edhe disa njerz tjerë që nuk kan detyra caktume gjë që e pamundeson të funksionoj si duhet, problem tjetër i Lepencit është borgji ndaj Atk-së, e shumë shumë problematika të tjera .Fatkeqsisht klubi Lepenci nuk e ka asnjë kategori të re, gjë e cila është e dëmshme për suksesin e një klubi dhe cila ndikon negativisht për të ardhmën e tij. Këtu duhet me qenë një planifikim më i qartë sepse ata sportista që janë aktualisht në klub, një ditë mund të largohen nga klubi dhe kjo paraqet një çeshtje serioze sepse është problematike të gjejn lojtar të mirë dhe të pregaditur.Duhet potencuar që zgjidhja e këtij problemi fillon nga planifikimi i mirëfilltë për organizmin dhe funksionalizmin e klubit të Lepencit në të gjitha instancat: si organizimi i mirë i agjendes, planifikimi i sakt i aktiviteteve ,raportimi mbi realizimin e aktiviteteve mbi bazen e korrektesisë dhe transparences, por është shumë e rëndësishme që edhe komuna ta shfrytzojë ndikimin e saj që punojt e këtij klubi të raportojn dhe te japin llogaridhenie si dhe të mbajn përgjegjesi ligjore mbi shpenzimet e realizimit të të gjitha aktiviteteve në këtë klub.

znj.Arta Avdiu: A ka ndonjë fond te hapur që investojn bizneset ?

z.Arben Thaqi : Egziston ligji për sponzorizim qe i lejon OJQ-të 30% tatimit fitim i një biznesi të madh dhe ato mjete i kompenzohen në tatimin fitim. Në këtë rast vetem ju dergon një vertetim, të cilin vertetim e merr në Ministrin e sportit dhe ne qeveri, ky vertetim tregon se cila ndermarrje ka me investu, pastaj OJQ-të obligohen ta bëjnë një raport për nderramrrjen e cila e ka përkrahur këtë OJQ. Mund të themi Ligji për sponzorizim këtu tek ne nuk aplikohet mjaftushem thuajse hiq . Nëse Lepenci kishte me apliku ose shfrytzu ligjin për sponzorizim për mjetet që i përfiton, besoj që kishte me funksionu më mir, mirpo për këtë nevojiten persona të cilet kanë energji të punojn drejt, dinjitetshem dhe të tregojn korrektësi dhe transparenc ndaj firmave. OJQ-të janë të obliguara të raportojn raportin e realizimit të gjitha aktiviteteve apo punve të OJQ-së, raportimin finaciar ndërsa firma duhet vetem me nenshkru atë program, mirëpo këtu egzistonë edhe një problem tjetër sepse tek firmat e mëdha të cilat veprojnë në Kaçanik, është problem me zgjedh partner të cilët janë në TVSH, poashtu hezitojn të bashkpunojnë për shkak se kanë hasur në keqperdorime.Eshtë shqetësuse fakti në ndarjen e granteve për disa OJQ të cilat kanë qenë pasive gjatë tërë vitit dhe nuk kan realizuar asnjë aktivitet në ç’rast ato duhet të elimonohen apo penalizohen e jo të favorizohen,sporti Kaçanik kam mendu se ka me qenë shum ma mir pas rregullimit të palestrës sportigve por përveq basketbollit që ka arritur deri në Play-off, ky është sukses për nivelin e garave qe ka arritur, ndërsa të tjerat sporte nuk kan pasur shum suksese të mëdha ,Mundja është përmend si sport individual dhe kanë shpenzime ma të vogla.Na me shkolla futbollit që punojn nuk kan konkuru një pjesë se ju kan thenë në drejtori komunale se nuk keni drejt me konkuru mirpo unë e kam shfrytzu si OJQ dhe kam konkuruar, i kam poseduar të gjithë dokumentacionin e nevojshem për aplikim por jam eliminuar si shkas i mungeses së vertetimit të çertifikates së regjistrimit që është dhe numri fiskal, disa kohë me parë kan qenë ndamas tani janë bashke edhe numri fiskal edhe numri i regjistrimit,në këtë rast unë i kam pas këto që nga viti 2019. Arsyetimi që më është dhenë për eleminimin tim, me keqardhje ju them se ka qenë arsyetim banal duke

u thirrur në atë se ka munguar numri fiskal dhe numri i regjistrimit të OJQ-së, ky arsyetim nuk qendron sepse une këto dokumente i kam të vitit 2019, tani jemi në vitin 2023 dhe une i posedojë dokumentat origjinale dhe mund ta deshmojë që ky është një fallsifikim se dikush nga komisioni kur kemi aplikuar i ka larguar dokumentet nga aplikimi.

z.Betim Shala: Edhe pse ato që ti kan heq janë disa gjera për të cilat janë të detyruar, po lidhem me prokurim konkretisht me zyrën e prokurimit kur të aplikon dikush për një tender, je i detyruar me i kontrollu dokumentat dhe çmimin, ligji thotë gjithmonë çmimi ma i lir i përgjegjshëm e merr , në këtë rast ti duhet me kontrollu dokumentacionin dhe me konstatu nëse aplikuesi i ka këto dokumente apo nuk e ka këtë dokument .Por janë disa kushte për cilat eliminohen automatikisht nëse nuk i ka dokumentet por dhe janë disa kushte për cilat duhet me e njoftu dhe me i shkru kompanisë që të mungon një dokument dhe se ka një afat për me i sjell dokumentet te cilat i mungojnë.

z.Arben Thaqi : Unë kam diskutuar me ta, por ata qellimshëm kanë dashur të më eliminojn, sepse ti e merr vertetimin nga Atk-ja, është një prej deshmive që ti je në rregull e vetmja gjë që ti je transparent dhe ke deklarë të hyrat e tua që i ke poseduar, por e rritesh se kjo gjë ka ndodhur qellimshëm pasi që nuk kan dashur me subvencionu një shkollë futbollit.

Ne mundem me ba hyrat prej prindeve ama kur subvencionohen OJQ-të, duhet me i pa dhe fëmijët .Na i paguim referat dhe mjeket ,fëmija a mundet me pas një hyrë jo se nuk mundet me pas rrogë ,a ka drejtë pune jo nuk ka ,unë mendojë që më së shumti duhet me u subvencionu fëmijët që janë kategori që kan nevoj për aktivitet ,ka po shkojnë ato fëmijë se ka edhe efektin tjetër dukurive negative ,një fëmijë po e shtim potencialisht nëse largohet përshkak kushteve mos me ardh me pagu po shtim me u marr me vepra penale unë mendoj që prioritet duhet me kan edhe mosha.

z.Ekrem Livoreka : Klubi i mundjes me të vërtetë na ka ba krenarë me garat Greqi andaj në vitet e ardhshme duhet me subvencionu më shumë përfshirë edhe të gjitha klubet e tjera që janë aktive.

3.Të ndryshme:

Kryesues i Komitetit Ekrem Livoreka: A keni diçka për të diskutuar në pikën të ndryshme ? Nëse jo, atëherë e shpalli mbledhjen të përfunduar, në ora 12:15.

**Procesmbajtësja
Mavije Murseli**

**Kryesues i Komitetit për Komunitete
Ekrem Livoreka**